Kronikë

VIDEO/ Fshehu në oborrin e banesës 3 armë zjarri dhe një gjahu, arrestohet 61-vjeçari në Fier

Një 61-vjeçar është arrestuar në Levan të Fierit, pasi mbante armë pa leje. Në pranga ka rënë Vladimir Mersini, i cili kishte fshehur 3 armë zjarri pistoleta, 1 armë gjahu dhe fishekë luftarak në një çantë në oborrin e banesës.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
6 Shtator, 11:14 | **Përditesimi: 6 Shtator, 11:20**

Share

FIER- Një 61-vjeçar është arrestuar në Levan të Fierit, pasi mbante armë pa leje. Në pranga ka rënë Vladimir Mersini, i cili kishte fshehur 3 armë zjarri pistoleta, 1 armë gjahu dhe fishekë luftarak në një çantë në oborrin e banesës.

"Në vijim të punës së pandërprerë në terren, për identifikimin, kapjen dhe arrestimin e shtetasve që posedojnë armë, pa leje, shërbimet e Komisariatit të Policisë Fier kanë siguruar informacion për një shtetas që fshihte armë zjarri dhe armë gjahu, në banesën e tij, në lagjen "1 Maji", Levan. Në bazë të këtyre informacioneve, u finalizua operacioni policor i koduar "Sinjali", në kuadër të të cilit u ushtruan kontrolle në banesën në pronësi të shtetasit Vladimir Mersini, dhe në territorin përreth saj.

LEXO EDHE:
VIDEO/ Aksident në Fier, përplasen dy mjete dhe përmbysen! Plagosen drejtuesit

Nga kontrollet, në një çantë të fshehur në oborrin e kësaj banese, shërbimet e Policisë gjetën 3 armë zjarri pistoleta, 1 armë gjahu dhe fishekë luftarak, të cilat posedoheshin pa leje. Armët dhe municioni luftarak u dërguan për ekspertizë, me qëllim verifikimin nëse janë përdorur ose jo, për ngjarje kriminale", njofton policia.

Ai akuzohet për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive".

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për veprime të mëtejshme.

Sl.E./r.k./Shqiptarja.com

TAG: armembajtje pa leje | Vladimir Mersini | Fier

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Kush e fiton ndeshjen Çeki-Shqipëri për kualifikueset e Euro 2024?

Çekia | Shqipëria | Barazim

Lajme të tjera

Zjarr në kodrat midis Radostinës dhe Shëndëllisë në Fier, digjen parcelat me ullinj! 4 zjarrfikëse po punojnë për të shuar flakët
6 Shtator, 15:49

Kallashnikov dhe municion luftarak në banesë, arrestohet 50-vjeçari në Berat! I dënuar më parë për armëmbajtje pa leje
6 Shtator, 10:38

Kultivuan kanabis në fshatin Murrizë të Lushnjës, arrestohen babë e bir dhe dy të afërm të tyre
6 Shtator, 09:30

VIDEO/ Shuhen vatrat e zjarrit në Zhamë të Lushnjës, digjen mbi 60 hektarë ullishte
6 Shtator, 07:56

VIDEO/ Zjarr në kodrat me ullinj të fshatit Zhamë në Lushnjë, arrestohet për zjarrvënie 58-vjeçari! Nesër pritet ndërhyrja e helikopterit
5 Shtator, 19:53

Ansambli i muzikës së dhomës "Bellini" koncert në Apoloni, instrumentistët italianë dhuruan momente magjike
4 Shtator, 15:20

Fier/ Makina përplaset me motorin në Roskovec, dy të lënduar
3 Shtator, 15:02

Paketa e Sigurisë në Shkolla, Balla nga Fieri: Qasje të ashpër për veprat penale që rrezikojnë nxënësit
2 Shtator, 14:40

VIDEO/ U vra në Ankona duke mbrojtur shokun, i jepet lamtumira në Lushnje Klajdi Bitrit, familja hap dyert e mortit! Balla: Do ta ndjekim gjyqin në Itali, drejtësia të vihet në vend
2 Shtator, 10:38

Divjakë/ Preku telat elektrikë me tubin e vaditjes, ndërron jetë 31 vjeçari në fshatin Biçukas, ishte duke ujitur misrin
2 Shtator, 09:37

VIDEO/ Përfshihet nga flakët një banesë në Fier
2 Shtator, 08:32

VIDEO/ U kap me 21 kg eksploziv, por kërkohej për zhdukjen e 'Koçoles' e Sulovarit, Albi Mecini njihet me masën e sigurisë! "Blindohet" gjykata e Sarandës
1 Shtator, 13:52

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje